



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 561/2 prot.

Tiranë, më 10.07.2020

VENDIM
Nr.54, datë 10.07.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 63, DATË 31.5.2019, NË
INSTITUCIONIN BASHKIA POLIÇAN

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 63, datë 31.5.2019, të Komisionerit, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Poliçan, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”*, ku shprehimisht është kërkuar: *“Të shqyrtohen me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”*, ka realizuar procesin e

verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë Poliçan, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 522/1 prot., datë 26.02.2019, ka raportuar se, megjithëse ka kohë që ka plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, vazhdon ende të jetë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunësi ***** (datëlindja.25.03.1952) në pozicionin e punës “Drejtore i Shërbimeve Publike”.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Poliçan, vendimin paralajmërues me nr. 63, datë 31.5.2019, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Poliçan, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia Poliçan, me shkresën nr.1515/1 prot., datë 30.6.2020, “Dërgohet informacion”, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur Bashkia Poliçan, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhëniet në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësin ***** në pozicionin e punës “Drejtore i Shërbimeve Publike”.
2. Pozicioni respektiv i punës, është shpallur pozicion i lire, për tu plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 63, datë 31.5.2019, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Poliçan, për marrjen e masave të

menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Poliçan.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Poliçan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha